



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

THIRRJE PËR OFERTË PËR KOMPANI DIZAJNUES/DIZAJNER PËR KRIJIMIN E FUSHATËS VETËDIJËSUESE

TERMAT E REFERENCËS

Emri i projektit: Mbështetja e grave të mbijetuara të dhunës seksuale

Zbatuar nga: Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështetur nga: UN Women Kosova

HYRJE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është një rrjet prej 190 organizatash për të drejtat e grave në Kosovë me mision për të mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në mbarë Kosovën, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, fetare, moshën, nivelin e arsimit, orientimin seksual dhe aftësinë. RrGK e përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informacionit, partneritetit dhe rrjetëzimit, hulumtimit, avokimit dhe shërbimeve. Anëtarët e RrGK-së janë përfitueset kryesore të RrGK-së, duke përfshirë gratë dhe vajzat të cilave u shërbejnë. Anëtarët e RrGK-së janë shumë të larmishme, duke punuar në mbarë Kosovën me gra të të gjitha etnive, aftësive, feve, dhe moshave në zonat rurale dhe urbane. Kjo ndihmon për të siguruar përfshirjen e grupeve dhe pakicave të pafavorizuara.

RrGK ka mbi 10 botime, disa të financuara nga agjencitë e OKB-së, që kanë trajtuar aspekte të ndryshme të dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe duke përfshirë edhe dhunën seksuale të ushtruar ndaj grave gjatë luftës. Këto kanë dhënë rekomandime konkrete politikash për krijimin e kuadrit ligjor përkatës.

Kur bëhet fjalë për llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore (DhBGj), ka ende shumë për të bërë. Edhe pse dhuna seksuale është kriminalizuar, pas iniciativave avokuese të RrGK-së të mbështetura nga ADA, në takime të ndryshme me palët e interesit si dhe hulumtimet e tjera të RrGK-së (2021) të mbështetura nga ADA për monitorimin e performancës institucionale të zbatimit të kornizës ligjore mbetet i dobët, për shkak të mungesës së kuptimit të kësaj dispozite nga institucionet përkatëse (policia, prokurorët, gjyqtarët). Në të vërtetë, hulumtimi i RrGK-së ka treguar se institucionet shpesh ngatërrojnë sulmin seksual me ngacmimin seksual, duke e parë këtë të fundit si të parëndësishme për ta trajtuar. Përdhunimi dhe dhuna seksuale mbeten tema tabu në shoqëri; edhe kur raportohen, gratë trajtohen në mënyrë jo dinjitoze nga institucionet. Kosovës i mungojnë qendrat e krizës së përdhunimit dhe qendrat e referimit të dhunës seksuale për viktimat edhe pse kërkohet nga Konventa e Stambollit. Jo të gjitha institucionet publike dhe vendet e punës, përfshirë kompanitë private, kanë politika kundër dhunës seksuale, procedura të brendshme dhe mekanizma për të raportuar rastet e dhunës seksuale për hetime të mëtejshme.

QËLLIMI

Ndërgjegjësimi i publikut dhe zyrtarëve mbi DhBGj-në dhe të drejtat e personave që kanë përjetuar dhunë është i rëndësishëm, duke përfshirë që rastet e DhBGj-së të raportohen në mënyrë që ato të mund të raportojnë dhunën dhe rastet e tyre të adresohen. Është e vështirë të zbatohet kuadri ligjor nëse viktimat nuk raportojnë rastet. Duke pasur parasysh tabutë dhe izolimin e lartpërmendur që mund të parandalojnë raportimin, rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit për llojet e mbështetjes në dispozicion dhe mënyrën e raportimit të dhunës është e rëndësishme për të inkurajuar institucionet që të zbatojnë kuadrin ligjor. Për

më tepër, rritja e ndërgjegjësimit është gjithashtu e rëndësishme për të transformuar normat sociale drejt reduktimit të DhBGj-së. Gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave, më 5 dhjetor 2022, u miratua Protokollin Shtetëror për Trajtim të Rasteve të Dhunës Seksuale, kështu që tani njerëzit duhet të jenë më të vetëdijshëm për të dhe si të realizojnë të drejtat e tyre. Andaj, fushata për të promovuar këtë protokoll është e rëndësishme në mënyrë që të gjithë të informohen për të dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.

Qëllimi kryesor i kësaj fushate është të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve lidhur me:

- 1) format e dhunës seksuale;
- 2) mënyrën se si gratë dhe burrat mund të përdorin Protokollin e ri të Shtetit mbi Dhunën Seksuale për të raportuar dhunën seksuale; dhe
- 3) cilat janë përgjegjësitë e institucioneve bazuar në Protokollin e Shtetit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

PËRSHKRIMI I DETYRAVE

Fillimisht, dizajnerët do të duhet të lexojnë hulumtimin e RrGK-së “Nga Ligjet në Vepra” dhe “Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale” për të kuptuar kornizën ligjore të Kosovës dhe njohuritë dhe qëndrimet e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e DhBGj-së. Këto informata duhet të frymëzojnë hartimin e materialeve të fushatës. Materialet do të diskutohen gjatë një takimi fillestar, në të cilin dizajnerët do të marrin pjesë. Detyrat përfshijnë:

1. Video e shkurtër e animuar që do të tregojë se çfarë është dhuna seksuale, si mund të përdoret Protokollin Shtetëror për të raportuar dhunën seksuale dhe përgjegjësitë e institucioneve.

RrGK do të sigurojë të gjithë përmbajtjen e tekstit për materialet (të diskutuara bashkë me dizajnerët) dhe do të punojë ngushtë me dizajnerët gjatë gjithë procesit. Të gjitha materialet duhet të prodhohen në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me RrGK dhe UN Women duke siguruar që dizajnet të jenë në përputhje me vizionin dhe misionin e partnerëve. Për këtë, këshillohet që dizajnerët të planifikojnë kohë për t'u takuar me partnerët në mënyrë periodike, sipas nevojës, për të diskutuar dhe rregulluar dizajnet.

Konceptet e dizajnit duhet të jenë produkte unike dhe origjinale (duke siguruar respektimin e ligjeve të së drejtës së autorit). Dizajnerët duhet të sigurojnë përfshirje në imazhet e përdorura (p.sh., duke përfshirë persona të etnive, moshave, gjinive dhe aftësive të ndryshme).

AFATI KOHOR

Aktivitetet	Datat e parashikuara
Kontraktori komplet projekt-konceptin, duke përfshirë 1 ilustrim	25 Janar
Rishikimi dhe komentet nga RrGK	31 Janar
Kontraktori finalizon videon	03 Shkurt
Rishikimi dhe komentet nga RrGK	07 Shkurt
Kontraktori finalizon konceptin dhe videon bazuar në komente	09 Shkurt
Video e finalizuar	10 Shkurt

Oferta duhet të dorëzohet në kosovawomensnetwork@gmail.com deri më 19 janar 2023 në ora 17:00 me temën “Fushata për Ndërgjegjësimin Publik – Protokollin Shtetëror”. Ofertat duhet të përfshijnë:

- Një propozim i shkurtër teknik me shembuj dhe/ose ide për fushatën;
- Një propozim financiar, i cili duhet të përfshijë koston për dorëzimin e vetëm. Oferta duhet të jetë pa Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe në shumën totale bruto duke përfshirë të gjitha shpenzimet; dhe
- Një portofol me punë të krahasueshme që demonstroi kapacitete.